



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura VI  
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-061

Prishtinë, më 22 mars 2019, në orën 10:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**PROCESVERBAL**

**I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 22 MARS 2019**

**Në mbledhje morën pjesë:** Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Kujtim Shala dhe Aida Dërguti, nënkryetarë të Kuvendit.

**Nga grupet parlamentare:** Avdullah Hoti, Memli Krasniqi, Ahmet Isufi dhe Albulena Balaj-Halimaj.

**Në mbledhje ishin të pranishëm:**

**Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit:** Avni Bytyqi.

**Nga Administrata e Kuvendit:** Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

**Nga NDI-ja:** Shefki Kastrati.

Mbledhjen e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit të Kuvendit, i zhvilloi punimet me këtë:

### **Rend dite**

1. Kërkesa e 49 deputetëve për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme,
2. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave.

#### **1. Kërkesa e 49 deputetëve për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme**

Kryetari i njoftoi të pranishmit se 49 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 69, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 38, pika 2c e Rregullores së Kuvendit, kanë kërkuar mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit, më 22 mars 2019, në orën 11:00, për miratimin e rezolutës lidhur me pezullimin e aktivitetit të kazinove dhe lojërave të fatit dhe plotësim-ndryshimin e ligjit përkatës.

Lidhur me kërkesën e 49 për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme diskutuan: Kujtim Shala, nënkryetar i Kuvendit; Avdullah Hoti, kryetar i GP të LDK-së dhe deputetja Albulena Balaj-Halimaj, në emër të GP të Nismës Socialdemokrate, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pas diskutimeve të lartshënuara, vendosi që seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit të mbahet të premtën, më 22 mars 2019, në orën 11:00, me këtë:

### *Rend dite*

- 1. Miratimi i Propozim-rezolutës lidhur me pezullimin e aktivitetit të kazinove dhe lojërave të fatit dhe plotësim-ndryshimin e ligjit përkatës.*

#### **2. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave**

- 1. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në SHBA*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

## V E N D I M

1. Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Vjosa Osman-Sadriu, Safete Hadërgjonaj, Doruntinë Maloku-Kastrati, Xhevahire Izmaqu, Arben Gashi dhe Fisnik Ismaili u lejoheu udhëtimi zyrtar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, prej 7 - 13 prill 2019.

2. Të gjitha shpenzimet për realizimin e këtij udhëtimi zyrtar, si dhe mëditjet për të lartshënuarit në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

### *2. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Francë*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

## V E N D I M

1. Nënkryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Xhavit Haliti, i lejoheu udhëtimi zyrtar në Paris (Francë), prej 19 - 22 maj 2019.

2. Të gjitha shpenzimet për realizimin e këtij udhëtimi zyrtar dhe mëditjet për të lartshënuarin në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

### *3. Kërkesa e deputetit Danush Ademi për lejimin e udhëtimit zyrtar në Luksemburg*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

## V E N D I M

1. Deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Danush Ademi, i lejoheu udhëtimi zyrtar në Luksemburg, prej 27 - 29 mars 2019.

2. Të gjitha shpenzimet për realizimin e këtij udhëtimi, si dhe mëditjet për të lartshënuarin në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës

### *4. Kërkesa e deputetit Etem Arifi për lejimin e udhëtimit zyrtar në Gjermani*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

## V E N D I M

Lejohet mbulimi i të gjitha shpenzimeve nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës (udhëtimin, akomodimit dhe mëditjet) për udhëtimin zyrtar të deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Etem Arifi, të realizuar në Gjermani, prej 14 - 18 mars 2019.

*5. Kërkesa e deputetit Slobodan Petroviq për aprovimin e shpenzimeve të tejkaluara për akomodim në lidhje me udhëtimin zyrtar, të realizuar në SHBA*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

## V E N D I M

Lejohet kompensimi i shpenzimeve të tejkaluara të akomodimit për deputetin Slobodan Petroviq në shumën prej 471.30 euro lidhur me vizitën zyrtare të realizuar nga 3 - 10 shkurt 2019 në Uashington D.C. SHBA.

*6. Kërkesa e deputetit Arben Gashi për ndryshimin e Vendimit nr. 06-V-437/1, datë 18. 1. 2019, në lidhje me udhëtimin zyrtar, të realizuar në SHBA*

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

## V E N D I M

Deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Arben Gashi, i lejohet mbulimi i shpenzimeve edhe për një ditë shtesë të qëndrimit në lidhje me udhëtimin zyrtar të realizuar nga data 4 - 11 shkurt 2019 në Uashington D.C. ShBA, për pjesëmarrje në “Lutjet e Mëngjesit”.

*7. Kërkesa e Shoqatës së personave me aftësi të kufizuara HANDIKOS Drenas për mbështetje financiare*

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

## V E N D I M

Shoqata e personave me aftësi të kufizuara HANDIKOS Drenas, me seli në Drenas, mbështetet financiarisht në shumën prej 4,980.00 euro për financimin e projektit “Kampi rehabilitues veror 2019 i personave me aftësi të kufizuara”.

*8. Kërkesa e Organizatës së personave me aftësi të kufizuara fizike HANDIKOS - PRISHTINË për mbështetje financiare*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Organizata e personave me aftësi të kufizuara fizike HANDIKOS - PRISHTINË, mbështetet financiarisht në shumën prej 4,999.00 euro për financimin e projektit “Përkrahja e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara që ofrohen në HANDIKOS-PRISHTINË”.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 10:50 minuta.

Kryetari i Kuvendit:  
Kadri VESELI

*Procesverbalin e hartoi:  
Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*